



ASPEKTE TË RËNDËSISHME TË VEPRIMTARISË SË VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Takimi theksoi rëndësinë e zbatimit të ligjit dhe praktikave profesionale që rregullojnë këtë profesion, duke nxjerrë në pah rolin e AMF-së dhe masave të marra në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit.

Vijon në faqen 2

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-mars 2012

Buletini jep pasqyrën e tregut të sigurimeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2012 ku vërehet rënie e disa treguesve krahasuar me tremujorin e parë të 2011.

Vijon në faqen 3

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2012

Transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) ishin ato që dominuan tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2012, në masën 70.26%.

Vijon në faqen 5

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Opinion – Mbi sigurimin e avancuar të Jetës

*Tonia Parascandolo, ACII, Cert. CIB Maltë, CeFA
Menaxhere – Banka e Valetës, Maltë.*

Vijon në faqen 7

Opinion - Mbi çështjet e ndryshme aktuariale

*Peter J. Murdza Jr, PhD., FCAS, ASA
Konsulent Aktuarial, nga Shoqata e Aktuarëve të Amerikës.*

Vijon në faqen 8

ZHVILLIME TË TJERA

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, gjatë periudhës 16-20 prill, zhvilloi trajnimin me temë “Sigurim i avancuar i Jetës me theks në aspektet e kontabilitetit për Kontratat e Jetës”.

Vijon në faqen 10

Iniciativa për Trajnimet mbi Mbikëqyrjen Financiare (TIFS) në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare Polake (PFSA) zhvilluan gjatë periudhës 11-13 prill, në Varshavë, Poloni, seminarin me temë: “Mbikëqyrja e ofertave publike dhe prospektit - rregullimi, standardet dhe praktikat”.

Vijon në faqen 11

Komisioni i Këmbimit të Letrave me Vlerë SEC, zhvilloi gjatë periudhës 16-26 prill, në Washington, Sh.B.A, trajnimin mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë.

Vijon në faqen 12

Komisioni për Letrat me vlerë i Malit të Zi dhe Qendra e Trajnimeve të Torontos (Toronto Centre), zhvilluan gjatë periudhës 22-27 prill seminarin mbi mbikëqyrjen e tregut të kapitaleve.

Vijon në faqen 13

TË REJA NGA RAJONI

Greqi: Tregu i Sigurimeve pëson rënie

Vijon në faqen 14

Çeki: Rënie në tregun e sigurimeve

Vijon në faqen 15

DISA ASPEKTE TË RËNDËSISHME QË LIDHEN ME VEPRIMTARINË E VLERËSIMIT TË DËMEVE NË SIGURIME

Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi vuri theksin tek rëndësia e zbatimit të ligjit dhe praktikave profesionale që rregullojnë këtë profesion, duke nxjerrë në pah rolin e AMF-së dhe masave të marra në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit.

Në datë 13 prill, Kryetarja e AMF-së, Zj. Enkeleda Shehi, zhvilloi një takim me vlerësuesit e pavarur të dëmeve në sigurime lidhur me çështjet që lidhen direkt me veprimtarinë e këtij profesioni relativisht të ri në tregun shqiptar të sigurimeve.

Në takim u diskutuan disa aspekte të rëndësishme, që lidhen me veprimtarinë e vlerësimit të dëmeve në sigurime, konkretisht:

- Licencimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë, si vlerësues dëmsh në sigurime;

Në fjalën e hapjes, Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi vuri theksin tek rëndësia e zbatimit të ligjit dhe praktikave profesionale që rregullojnë



Gjatë takimit me vlerësuesit e pavarur të dëmeve në sigurime



Nga e majta në të djathtë:
Znj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike; Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e AMF-së;
Znj. Enkela Idrizi, Nënkryetare e AMF-së dhe Znj. Flora Musta, Drejtore e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit

këtë profesion, duke nxjerrë në pah rolin e AMF-së dhe masave të marra në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit. Kryetarja e AMF-së, Znj. Shehi parashtrroi dhe mundësinë e organizimit të trajnimeve të mundshme në këtë fushë dhe la të hapur mundësinë që tregu dhe profesionistët e kësaj fushe të sjellin propozime të mëtijshme për udhëzues konkretë që tregu i arsyeton të nevojshëm në fazën aktuale të zhvillimit të këtij profesioni.

Gjatë takimit u diskutua mbi problematikat e konstatuara nga shqyrtimi i disa akteve të ekspertimit, në rastet kur vlerësuesit e pavarur thirren si ekspertë nga Gjykata për konstatimin ose sqarimin e ngjarjeve, të cilat kërkojnë njohuri të posaçme në fushën e vlerësimit të dëmeve. Në vijim u prezantuan dhe disa nga hapat e ndërmarra nga AMF në lidhje me konfliktin midis rregullimeve të përdorura, që trajtojnë në mënyra të ndryshme kërkesën për dëmshpërblim.

- Masat administrative ndaj vlerësuesve të dëmeve;
- Problematikat e konstatuara nga shqyrtimi i disa akteve të vlerësimit;
- Legjislacioni i zbatueshëm për vlerësimin e dëmeve nga vlerësuesit.

Në takim, krahas profesionistëve të licencuar, ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga Shoqata e Sigurimeve. Gjatë takimit u prezantuan dhe formularët e rinj të raportimit periodik të hartuar nga AMF, posaçërisht për vlerësuesit e dëmeve, me qëllim pasqyrimin më të qartë të praktikave të punës së tyre.

Gjithashtu, Autoriteti bëri me dije se, është në komunikim të vazhdueshëm edhe me gjykatat e rretheve gjyqësore,

të Apelit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë e Ministrinë e Drejtësisë për të orientuar gjyqtarët për trajtimin e çështjeve gjyqësore që lidhen me shpërblimin e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Në përfundim, duke qenë se Autoriteti po punon edhe për disa ndryshime në ligjin e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, vlerësuesit e pavarur të dëmeve u ftuan të japin sugjerimet e tyre.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-mars 2012

<http://amf.gov.al/news.asp?id=691>



Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-mars 2012 arritën shifrën 1,882,184 mijë lekë, përkundrejt 2,233,681 mijë lekë të realizuara në janar-mars 2011 ose 15.74% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Ndikim më të madh në uljen e tregut kanë patur sigurimi i detyrueshëm motorik, Kartoni Jeshil dhe sigurimi Aksidente dhe shëndet me peshë rreth 83% të uljes totale të tregut. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 55.36% dhe ato të

sigurimit të detyrueshëm 44.64% të tregut. Përsa i takon tregjeve, në veçanti, kemi një rënie në masën 4.90% të sigurimeve të Jetës dhe një rënie prej 17.22% të sigurimeve të Jo-Jetës. Nga të ardhurat gjithsej të tregut 86.41% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 13.59% nga veprimtaria e Jetës.

Në janar-mars 2012 u nënshkruan rreth 218,770 kontrata sigurimi, ose 26.32% më pak se në janar-mars 2011.

Ndikim më të madh në uljen e tregut kanë patur sigurimi i detyrueshëm motorik, Kartoni Jeshil dhe sigurimi Aksidente dhe shëndet me peshë rreth 83% të uljes totale të tregut.

Struktura e tregut të sigurimeve, për janar-mars 2011




Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-mars (2011-2012)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2011	2012
janar-mars		
A) Sigurim i Jetës	268,875	255,706
B) Sigurim i Jo-Jetës	1,964,805	1,626,477
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	953,548	840,137
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	1,011,257	786,341
C) Risigurimi	-	-
TOTAL	2,233,681	1,882,184

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-mars 2012 arritën në 56,481 mijë lekë, apo 17.98% më shumë se në janar-mars 2011.

Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-mars 2011 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-mars 2012, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 840,137 mijë lekë të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-mars 2012, arritën 605,675 mijë lekë, ose 8.90% më shumë se janar-mars 2011.

Në janar-mars 2012, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 177,980 mijë lekë, ose rreth 49.08% më pak se në janar-mars 2011. Kjo ulje e primit shkruar bruto Karton Jeshil lidhet me liberalizimin tregut të sigurimit të detyrueshëm në gusht të vitit 2011.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-mars 2012 arritën në 56,481 mijë lekë, apo 17.98% më shumë se në janar-mars 2011.

Sigurimet vullnetare

Për janar-mars 2012, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,042,047 mijë lekë, ose 18.60% më pak se të ardhurat e janar-marsit 2011.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 786,341 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me 49.58 % të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 18.70% dhe nga sigurimi kasko me 16.62%, peshë më të ulët patën sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile, sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-mars 2012, arritën në 147,041 mijë lekë, 42.38 % më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e klasës 1, sigurimi i aksidenteve me 56.11% të të ardhurave të këtij grupi.


Primet në sigurimet e jetës në janar-mars 2012 arritën në 255,706 mijë

lekë, ose 4.90% më pak se në janar-mars 2011.


Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal Uniq Group Austria, Sigma Vienna Insurance Group, Insig, Atlantik, Interbalkan, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal Uniq Group Austria udhëhoqi tregun me 29.81% të primeve.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-mars 2012 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-mars 2012 (Jeta)



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life Uniq Group Austria, Insig dhe Sicred. Sigal-Life Uniq Group Austria udhëhoqi tregun me 38.77 % të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-mars 2012 kapi vlerën 722,407 mijë lekë, ose 42.85% më shumë se në janar-mars 2012. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 440,377 mijë lekë, apo 60.96% të totalit.

TREGU ME PAKICË I LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2012

<http://amf.gov.al/news.asp?id=683>

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2012 u dominua në masën 70.26% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (*bono thesari*) dhe 29.74% nga instrumenta afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 96.00% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë

transaksioneve të kryera me bono thesari.


Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2012, flasin për një dominim të transaksioneve “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Blerje në tregun primar” përkatësisht me 34.95%

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2012, flasin për një dominim të transaksioneve “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Blerje në tregun primar” përkatësisht me 34.95% dhe 30.63% kundrejt volumit të përgjithshëm.

dhe 30.63% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 97.05% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Letra me Vlerë të Qeverisë 2011 / Government securities 2011



*

- A - Blerje ne tregun primar
- B - Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C - Blerje nga individët para afatit të maturimit
- D - Vendosje e bonos si kolateral
- E - Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë 2011, 2012

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi `12/11-1
	2011	2012	
Letra me Vlerë të Qeverisë			
B			
Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	1,763.41	2,215.26	42.47
<i>Individë</i>	1,405.18	1,535.26	9.26)
<i>Persona juridikë</i>	358.23	976.99	172.73
C			
Blerje nga individët para afatit të maturimit	814.61	941.84	15.57
<i>Individë</i>	396.14	408.43	3.10
<i>Persona juridikë</i>	418.47	533.05	27.38

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-mars 2012 ka patur një rritje prej 748.85 milionë lekë ose në masën **42.47%**, krahasuar me periudhën janar-mars 2011. Numri i këtyre transaksioneve ka patur një rritje në masën **0.41%**.

Transaksioni i llojit C “Blerje nga individët para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar- mars 2012 ka patur një rritje prej 126.87 milionë lekë ose **15.57%**, krahasuar me periudhën janar-mars 2011. Numri i këtyre transaksioneve ka patur një ulje në masën **4.02%**.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth **875.52** milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-mars 2011.

Në periudhën janar-mars 2012 vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth 875.52 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-mars 2011.

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Sigurimi i avancuar i Jetës – Opinion

- **Tonia Parascandalo, me diplomë të Avancuar nga Instituti i Certifikuar i SigurimeveACII, certifikuar nga Instituti i Certifikuar i Bankierëve CIB Maltë, certifikuar si Konsulent Financiar**

(Certificate for Financial Advisers) CeFA

Në trajnimin mbi “Sigurimin e avancuar të Jetës me theks në aspektet e kontabilitetit për Kontratat e Jetës”, që AMF zhvilloi gjatë periudhës 16-20 prill, një ndër lektorët ishte Znj. Tonia Parascandalo, bashkëpunëtore e Institutit të Certifikimeve në Sigurime në Britaninë e Madhe e njëkohësisht, pedagoge në Qendrën Mesdhetare të Trajnimeve në Sigurime. Znj. Tonia Parascandalo, që prej vitit 1985, ka qenë drejtuese e departamenteve të ndryshme të Bankës së Valetës, Maltë dhe që nga 2010, është emëruar si Menaxhere Bankare në një degë të Bankës së Valetës, BOV.

Opinionin e saj për mundësitë e zhvillimit të mëtejshëm të tregut të Sigurimit të Jetës në Shqipëri e lexoni me poshtë.

Sigurimi i Jetës është çështje mentaliteti në të gjithë vendet në zhvillim. Shpesh ne mendojmë për nevojën e sigurimit të Jetës, vetëm kur ndodh një aksident, ose kur ky aksident ndodh në familje. Kështu, është mirë që njerëzit të fillojnë të mendojnë në lidhje Sigurimin e Jetës, me atë se çfarë ndodh nëse vdes personi që mban familjen, në qoftë se një person humb punën për shkak të një aksidenti ose sëmundje. Ndoshta, më vonë, ata mund të shqyrtojnë edhe mundësinë për të marrë policat e sigurimit të Jetës si një plan alternativ kursimesh.

Shumica e vendeve të zhvilluara në botë kanë vendosur përfitime tatimore për t'i bërë më tërheqëse produktet e sigurimit, që janë të kombinuara me investime. Njerëzit duhet ta marrin parasysh këtë dhe nga ajo që unë kam mundur të shoh në faqet e internetit, për tre shoqëritë e mëdha të sigurimit në Shqipëri, primet janë të përbalueshme dhe njerëzit duhet të mendojnë të fillojnë të kursejnë.

Rritja e ndërgjegjësimit i publikut për këto produkte është shumë i

rëndësishëm. Shoqëritë e mëdha të sigurimeve duhet t'i bëjnë produktet më të lehta për t'u kuptuar nga njerëzit, ato duhet t'i bëjnë produktet e tyre të përdorshme, me gjuhë të qartë, në mënyrë që të gjithë të mund t'i kuptojnë dhe jo të përdorin zhargone teknike. Nga përvoja që unë kam në Maltë, njerëzit kanë tendencë të bëjnë sigurimin si fillim vetëm për jetën e debitorit dhe unë e di që edhe ju e keni këtë këtu, sepse kjo është e detyrueshme nga bankat. Por, më pas, njerëzit e kuptojnë se ata duhet të fillojnë kursimin për shkak të problemeve të pensioneve që po hasin shumica e vendeve. Ata mund ta kuptojnë se sigurimi i kombinuar me investime mund të jetë me të vërtetë një alternativë shumë të mirë investimi edhe për ata që janë konservatorë.

Mbrojtja e konsumatorit dhe ndërgjegjësimit i publikut janë shumë të rëndësishme në këtë proces. Njerëzit, së pari duhet të besojnë tek shoqëritë e sigurimeve, ashtu si kur duhet të depozitojnë paratë në bankë. Ndoshta me kalimin e kohës shqiptarët do të jenë të gatshëm madje për të investuar

Shoqëritë e mëdha të sigurimeve duhet t'i bëjnë produktet më të lehta për t'u kuptuar nga njerëzit, ato duhet t'i bëjnë produktet e tyre të përdorshme, me gjuhë të qartë, në mënyrë që të gjithë të mund t'i kuptojnë dhe jo të përdorin zhargone teknike.

në produkte më të ndërlikuara, në produkteve të lidhura me investime në fonde, të cilat po përdoren në vendet më të zhvilluara për planifikimin e pensionit. Në Maltë kanë filluar ngadalë, por gjithnjë e më shumë njerëz po e kuptojnë se nëse ata duhet investojnë në mënyrë afatgjatë, ata duhet t'i drejtohen produkteve të lidhura me investimet në fonde.

Edhe pse nuk ka bursë në Shqipëri, kjo nuk duhet t'i pengojë shoqëritë e sigurimeve që të ofrojnë produkte në mënyrë afatgjatë. Në Maltë ka 1/8 e popullsisë krahasuar me Shqipërinë. Edhe pse në krahasim me vendet e tjera evropiane ky numër mund të jetë i vogël, padyshim ka vend për më

shumë produkte, veçanërisht produkte afatgjata sigurimi për planifikimin e daljes në pension dhe që mund të ofrohen investime në fonde dhe, ndoshta, madje edhe një kombinim investimesh me fitim të garantuar, në mënyrë që edhe njerëzit, të cilët janë hezitues, do të jenë të gatshëm për të investuar në mënyrë afatgjatë.

Shumica e publikut e di, se kur investon në bono, merr një fitim të caktuar. Por aksionet, duke parë grafikët e luhatjes së tyre, del shumë e qartë se ato japin një fitim më të lartë në planin afatgjatë. Pra, le të shpresojmë se kjo është rruga përpara për Shqipërinë. Unë jam e sigurtë se, kur ka funksionuar një treg i vogël si ai i Maltës, me siguri që do të funksionojë edhe në Shqipëri.

Mbi çështjet e ndryshme aktuariale - Opinion

Peter J. Murdza Jr, përfaqësues i Shoqatës së Aktuarëve të Jo-Jetës (Casualty Actuarial Society) FCAS dhe Shoqatës Aktuariale të Amerikës (Actuarial Society of America) ASA

Në trajnimin mbi çështjet e ndryshme aktuariale, që u zhvillua gjatë periudhës 19-23 mars nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me FSVC-në, për përmirësimin dhe zhvillimin cilësor të praktikave të punës në Autoritet, lektori që drejtoi trajnimin ishte Peter J. Murdza . Peter J. Murdza është anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Aktuarëve pa Kufij, që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e aktuaristikës që prej vitit 1914. Opinionin e Dr. Muzda për aktualët e lexoni me poshtë.

Çfarë do të thotë aktuar? Çfarë është një aktuar? Nga një pjesë e madhe e njerëzve nuk është dëgjuar ky term. Sipas faqes së internetit të Shoqatës së Aktuarëve të Jo-Jetës (<http://www.casact.org>), aktuari është, një profesionist i aftë në vlerësimin, analizën dhe menaxhimin e implikimeve financiare të ngjarjeve të ardhshme të paparashikuara, në lidhje me sigurimin. Çfarë do të thotë kjo?

Së pari, një aktuar fokusohet mbi ngjarjet e paparashikuara që mund të ndodhin në të ardhmen, ngjarje, zhvillimi i të cilave është i pasigurt, ato që ndodhin rastësisht ose nga

aksidentet. Ato përfshijnë aksidente automobilistike, zjarret, lëndimet personale, tërmetet dhe ngjarjet me pasoja vdekjen. Së dyti, një aktuar fokusohet në efektet financiare të dukurive të tilla, kur ato janë të mbuluara nga sigurimi. Është detyra e aktuarit për të përcaktuar nivelin e mbulimit që një shoqëri duhet të marrë përsipër ndaj blerësit të një lloji të caktuar të sigurimit për një mbulim të dhënë. Meqenëse ngjarja ndodh në të ardhmen dhe është e pasigurt,

ajo kërkon që aktuari të ndërmarrë një numër vlerësimesh, p.sh., probabilitetin e humbjes në ngjarjen e ndodhur, shumën mesatare të një humbje, shpenzimet e ardhshme administrative të siguruesit dhe fitimin e duhur të siguruesit.

Aktuarët, gjithashtu, janë të përfshirë në fusha të tjera të biznesit të sigurimeve. Ata vlerësojnë sasinë e parave që një sigurues duhet të lërë mënjanë për të paguar për aksidentet që kanë ndodhur tashmë, pra të përlogarisë rezervat e siguruesit. Ata gjithashtu mund të analizojnë portofolin e investimeve të siguruesit, të përcaktojnë nëse investimet e tij janë të cilësisë së duhur dhe nëse ata do të sigurojnë një sasi të ardhurash që do të përputhet me pagesat e pritshme të dëmeve në të ardhmen.

Edhe pse profesioni aktuarit zhvillohet së bashku me industrinë e sigurimeve, vetëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë ky profesion u organizua formalisht. Instituti i aktuarëve u themelua në Londër në vitin 1848. Në Shtetet e Bashkuara, Shoqata e Aktuarëve e përbërë nga aktuarë të specializuar në fushën e pensioneve dhe në sigurimin e Jetës dhe shëndetit u themelua në vitin 1889. Shoqata Aktuariale e sigurimeve të Jo-Jetës dhe të sigurimit nga aksidentet (p.sh., zjarri, mjetet motorike, dhe sigurimi i përgjegjësisë), u themelua në vitin 1914.

Të dyja shoqëritë amerikane administrojnë një program të vështirë dhe të gjerë edukimi. Aktualisht të dyja kërkojnë përvetësimin e tre subjekteve (ekonomisë, financës, dhe statistikat e aplikuara) përmes kurseve dhe kalimin e nëntë provimeve të tjera. Përfundimi i programit të plotë, i cili mund të marrë më shumë se dhjetë vjet, çon në marrjen e statusit si një anëtar i shoqatës. Marrja e titullit si anëtar i shoqatës fitohet pas kalimit të një pjese të provimeve të kërkuara.

Shoqëritë aktuariale janë të përhapura në shumë vende të botës. Shumica e këtyre shoqërive janë anëtarë të Shoqatës Ndërkombëtare Aktuariale, e cila u themelua në vitin 1895. Aktualisht ajo ka 64 anëtarë me të drejta të plota dhe 26 anëtarë të asociauar. Struktura e saj organizative përfshin dy komitete, të tilla si ajo e këshillimit dhe asistencës dhe ajo e asistencës e seksioneve të specializuara, si p.sh. ajo e aktuarëve pa kufi.

Në Shqipëri, profesioni i aktuarit është vetëm në fillimet e zhvillimit. Me ndihmën e Trupës Vullnetare të Shërbimeve Financiare (FSVC) dhe Institutit të Aktuarëve në Mbretërinë e Bashkuar, AMF ndërmori dy programe të trajnimit (2006-2007 dhe 2009-2011) për të trajnuar dhe certifikuar aktuarët e rinj. Gjithashtu aktuarë nga Banka Botërore dhe Shoqata Aktuarët pa Kufi kanë trajnuar aktuarët shqiptarë. Aktualisht janë 19 aktuarë në Shqipëri, 13 prej të cilëve janë të autorizuar nga AMF.

Aktuarët, gjithashtu, janë të përfshirë në fusha të tjera të biznesit të sigurimeve. Ata vlerësojnë sasinë e parave që një sigurues duhet të lërë mënjanë për të paguar për aksidentet që kanë ndodhur tashmë, pra të përlogarisë rezervat e siguruesit.

ZHVILLIME TË TJERA

Sigurimi i avancuar i jetës me theks në aspektet e kontabilitetit për kontratat e jetës

Duke bërë krahasim edhe me vendet e tjera të rajonit, trajnerët nxitën nevojën e ndërgjegjësimit më të madh të publikut për Sigurimin e Jetës, si dhe nevojën që shoqëritë e sigurimit në vend të ofrojnë produkte të qarta e të kuptueshme prej publikut.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, gjatë periudhës 16-20 prill, zhvilloi trajnimin me temë “Sigurimi i avancuar i Jetës me theks në aspektet e kontabilitetit për Kontratat e Jetës”. Gjatë trajnimit u shpjeguan koncepte teorike, si dhe u dhanë situata e raste praktike për produktet e Sigurimit të Jetës. Trajnerët e Qendrës Ndërkombëtare të Trajnimit të Maltës, Mrs. Tonia Parascandalo dhe Mr. Dadi Demarco, me eksperiencën e tyre, realizuan një trajnim interaktiv, me diskutime për rastet dhe mundësitë e aplikimit të produkteve të Sigurimit të Jetës në Shqipëri. Duke bërë krahasim edhe me vendet e tjera të rajonit, ata nxitën nevojën e ndërgjegjësimit më të madh të publikut për Sigurimin e Jetës, si dhe nevojën që shoqëritë e sigurimit në vend të ofrojnë produkte të qarta e të kuptueshme prej publikut.

Ndër çështjet kryesore që u trajtuan përmendim:

- Sigurimi i Jetës dhe produktet e lidhura me investimet, të pranishme në treg; Si nënshkruhet një policë Sigurimi Jete dhe cilat janë arsyet e marrjes së saj; Llojet kryesore të policave të Jetës;
- Administrimi i policave që ndikojnë tek produktet e Sigurimit të Jetës dhe faktorët e marrjes në sigurim;
- Parimet ligjore për vlefshmërinë e kontratës; Procedura e vlerësimit dhe marrjes së vendimit për të pranuar riskun; Nënshkrimi i policës



Gjatë zhvillimit të trajnimit mbi sigurimin e avancuar të jetës me theks në aspektet e kontabilitetit për kontratat e jetës

së Sigurimit të Jetës dhe faktorët e riskut që lidhen me të; Llogaritja e primit;

- Risigurimi dhe dëmet e Sigurimit të Jetës;

Gjithashtu, në trajnim u shtjelluan edhe koncepte teknike në Sigurimin e Jetës siç ishin Kontabiliteti i Sigurimit të Jetës (me fokus SNRF) dhe Kërkesat e Solvency II, si dhe ndryshimet nga regjimi aktual.

Pjesëmarrës në takim ishin 24 specialiste nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, punonjës të shoqërive të Sigurimit të Jetës që veprojnë në tregun shqiptar si edhe nga Banka Qendrore e Kosovës, të specializuar në çështjet e Sigurimit të Jetës. Trajnimi ishte ndërtuar në vazhdimësi të politikave për rritjen e kualifikimit profesional të punonjësve të Autoritetit dhe të shoqërive të sigurimeve. Të gjithë pjesëmarrësit vlerësuan trajnimin si një drejtim i ri i zhvillimit të punës së tyre.

MBIKËQYRJA E OFERTAVE PUBLIKE DHE PROSPEKTIT - RREGULLIMI, STANDARDET DHE PRAKTIKAT

Iniciativa për Trajnimet mbi Mbikëqyrjen Financiare (TIFS) në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare Polake (PFSA) zhvilluan gjatë periudhës 11-13 prill, në Varshavë, Poloni, seminarin me temë: “Mbikëqyrja e ofertave publike dhe prospektit - rregullimi, standardet dhe praktikat”.

Gjatë seminarit u trajtuan aspektet kryesore të mbikëqyrjes dhe rregullimit të ofertave publike dhe prospektit në Bashkimin Evropian, të para nga këndvështrimi polak, duke përfshirë politikat rregulluese dhe praktikat e këtij tregu. TIFS në këtë trajnim ofroi njohuri të dala nga eksperiencat, praktikat dhe teknikat financiare të mbikëqyrjes.

Në seminar u trajtuan çështje teorike të ndjekura nga përdorimi i praktikave të njohura, në mënyrë që t'u ofronin pjesëmarrësve shembuj të bazuar në çështje konkrete, për të paraqitur zbatimin efektiv të metodave dhe teknikave të rregullave dhe mbikëqyrjes.

Seminari ishte konceptuar për interesin e mbikëqyrësve, të cilët mbikëqyrin ofertat publike dhe miratimin e dokumentacionit të kërkuar në rastet e ofertave publike të titujve. Qëllimi i seminarit ishte promovimi i një komunikimi efektiv dhe shkëmbimi i eksperiencave, në mënyrë që ti jepte mundësi pjesëmarrësve të ndanin në mënyrë aktive eksperiencat nga praktikat dhe standardet më të mira të mbikëqyrjes. Ky program ishte projektuar si një forum për shkëmbimin e praktikave më të mira për zhvillimin dhe rregullimin e tregjeve të titujve, të



Pjesëmarrës në seminarin: “Mbikëqyrja e ofertave publike dhe prospektit - rregullimi, standardet dhe praktikat”

prezantuara këto nëpërmjet leksioneve, tavolinave të rrumbullakëta dhe studimit të rasteve të ndryshme, të përqendruara në nevojat dhe interesat e përbashkëta të vendeve nga Evropa Qendrore dhe Lindore si dhe vendet e BE-së.

Theksi u vendos në kuadrin rregullator kryesor, si dhe zgjidhjet praktike të propozuara nga BE për çështjet që lidhen me prospektin dhe ofertat publike. Ndër temat kryesore të prezantuara nga ekspertë të fushave të PFSA-së, nga Bursa e Varshavës, si dhe përfaqësuesve të tregut, përmendim:

- Aspektet ligjore dhe organizative të ofertave publike;
- Pranimi i titujve për tregtim në tregjet e rregulluara;
- Mbikëqyrja nga PFSA i ofertave publike dhe reklamimi i tyre;
- Procesi i miratimit të prospektit në praktikë - aspektet ligjore dhe procedurale të procesit të miratimit, duke përfshirë edhe procesin e shqyrtimit;
- Informacioni që duhet përfshirë në prospekt sipas kërkesave të legjislacionit Evropian;

Në seminar iu ofrua pjesëmarrësve shembuj të bazuar në çështje konkrete, për të paraqitur zbatimin efektiv të metodave dhe teknikave të rregullave dhe mbikëqyrjes.

- Detyrimet e raportimit financiar periodik të emetuesve dhe zbatimi i këtyre detyrimeve, si dhe;
- Rregullat evropiane për sa i përket historikut të informacionit financiar në prospekt duke e ilustruar me shembuj.

ZHVILLIMI I TREGUT TË LETRAVE ME VLERË

Komisioni i Këmbimit të Letrave me Vlerë (Securities Exchange Commission) SEC, zhvilloi gjatë periudhës 16-26 prill trajnimin mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë, në Washington, SH.B.A. Në këtë trajnim merrnin pjesë përfaqësues nga 73 autoritete të ndryshme rregullatore.

Ndër temat kryesore që u trajtuan gjatë këtij trajnimi, përmendim:

Mbikëqyrja dhe zhvillimi i Tregut të Letrave me Vlerë. Qëllimi i kësaj teme ishte shpjegimi pse tregu i letrave me vlerë duhet të funksionojë në bazë të një legjislacioni të fortë. Kjo mund të arrihet me anë të sfidave rregulluese, mjeteve dhe përafrimeve të reja legjislative;

Zbatueshmëria e legjislacionit. Nëpërmjet kësaj teme u diskutua mbi forcimin e hetimit dhe ndjekjes së manipulimeve që bëhen në treg. Gjithashtu u vu theksi edhe tek zbatimi i ligjeve penale të letrave me vlerë;

Korporata financiare, zbulimi dhe qeverisja korporatave. U trajtua edukimi i investitorëve për shkak të një numri në rritje të tyre, të produkteve të ndryshme komplekse, të investitorëve “konfuzë”, si dhe mbrojtjes së besimit të pakët të mbetur nga ana e tyre;

Pajtueshmëria, inspektimi dhe ekzaminimi i Tregut të Letrave me Vlerë. Kjo temë u bazua në mbikëqyrjen me fokus riskun, e cila duke zbatuar standardet e duhura do të çonte drejt

një ekzaminimi sa më të saktë nga ana e brokerave dhe ndërmjetësve;

Zhvillimi i Tregut të Letrave me Vlerë. Tema shtjelloi qeverisjen e korporatave duke analizuar teorinë, konceptet dhe principet e saj. Problemi kryesor që ngriti kjo temë ishte mbrojtja e investitorëve të huaj (pakicat e aksionarëve dhe kreditorëve) nga shpronësimi i investitorëve të brendshëm (menaxherët dhe aksionarët kontrollues). Zgjidhja e këtij problem do të çonte drejt rritjes së vlerës së ndërmarrjes së një korporate të investitorëve.

Gjithashtu u diskutua mbi tregun e brendshëm, manipulimin e tregut, si dhe mashtrimin e kontabilitetit financiar. U trajtuan dy studime. Në të parin u diskutua për Tregtimin e Shpejtë (Fast Traders). Objektivi primar i këtij studimi ishte rasti i të mësuarit sesi ekzaminuesit mund të kryejnë një ekzaminim brokeri. Posaçërisht, ky studim shqyrton rastet kundër pastrimit të parave, tregtisë së paautorizuar, përshtatshmërinë dhe mbikëqyrjen.

Në studimin e dytë u fol për Këshilluesit “Crimson” (Crimson Advisers). Objektivi primar i këtij studimi ishte të mësuarit se si një ekzaminues mund të kryejë një përmbledhje të një konfliktit të caktuar të interesit gjetur brenda një “shporte fondesh mjedisore. Ky rast studimi hodhi dritë në zonat me rrezik potencial, procedurat e kontrollit, të tilla si pajtim i kontrolleve operative.

Objektivi primar i këtij studimi ishte rasti i të mësuarit sesi ekzaminuesit mund të kryejnë një ekzaminim brokeri. Posaçërisht, ky studim shqyrton rastet kundër pastrimit të parave, tregtisë së paautorizuar, përshtatshmërinë dhe mbikëqyrjen.

MBIKËQYRJA E TREGUT TË KAPITALEVE

Komisioni për Letrat me vlerë i Malit të Zi dhe Qendra e Trajnimeve të Torontos (Toronto Centre), zhvilluan gjatë periudhës 22-27 prill seminarin mbi mbikëqyrjen e tregut të kapitaleve.

Seminari u fokusua në prezantimin, trajtimin dhe diskutimin e disa prej problemeve kryesore që përballen Autoritet Mbikëqyrëse në tregjet e letrave me vlerë. Temat kryesore të trajtuara gjatë seminarit lidheshin me sfidat që duhen përballuar për të përmirësuar strukturat mbikëqyrëse, proceset e krijimit të aftësive dhe zbatimi i planeve konkrete, sistemet e mbikëqyrjes me fokus riskun, rastet e skemave Madoff Ponzi, qeverisja e korporatave (corporate governance), si dhe raste studimi konkrete. Më konkretisht:

Sfidat që duhen përballuar për të përmirësuar strukturat mbikëqyrëse - objekti i kësaj teme ishte prezantimi dhe diskutimi mbi strukturat e ndryshme organizative, faktorët përcaktues mbi zgjidhjen e llojit të strukturës, sfidat e përgjithshme që vijnë nga përdorimi i strukturave të ndryshme dhe implikacionet që kjo ka mbi rregullatorët.

Proceset e krijimit të aftësive pri-jëse dhe zbatimi i planeve konkrete - tema trajtoi procesin e vendimmarrjes dhe zbatimin e një plani konkret mbi trajtimin e sfidave konkrete të përballuara gjatë punës.

Komunikimi efektiv dhe menaxhimi i personave të interesit - kjo temë kishte si objekt prezantimin e një përfaqëse të mundshme për t'u përdorur në komunikimin dhe bindjen e palët e interesuara për të mbështetur punën/projektin tuaj. Konkretisht u sugjerua aplikimi i modelit "4 box" mbi komunikimin dhe bindjen efektive.

Sistemet e mbikëqyrjes me fokus riskun rastet e skemave Madoff Ponzi - kjo temë trajtoi prezantimin e metodologjive të ndryshme të mbikëqyrjes me fokus riskun dhe mbikëqyrjen bazuar mbi rregullat. Testimi i aftësive për të identifikuar risqet duke përdorur raste konkrete. U diskutua mbi elementët e sistemit të mbikëqyrjes. Gjithashtu, në vazhdim, mbi këtë temë u trajtuan dhe raste të skemave piramidale "top - down", raportimeve jo të sakta, "fluskave spekulative", etj.

Corporate Governance - kjo temë trajtoi raste studimi të ndryshme nga rajoni i Ballkanit, roli i rregullatorëve në forcimin e corporate governance në sektorin e letrave me vlerë. Në këtë program morën pjesë përfaqësues të Autoriteteve Mbikëqyrëse nga Evropa Qendrore dhe Lindore. U trajtuan shume raste studimi të cilat synonin ti jepnin mundësinë përfaqësuesve të vendeve pjesëmarrëse në seminar të ndajnë eksperiencat e tyre dhe të diskutojnë për temat e prezantuara.

Seminari u fokusua në prezantimin, trajtimin dhe diskutimin e disa prej problemeve kryesore që përballen Autoritet Mbikëqyrëse në tregjet e letrave me vlerë.

TË REJA NGA RAJONI

Greqi: Tregu i Sigurimeve pëson rënie

www.xprimm.com

Sipas një studimi të Shoqatës së Siguruesve Grekë, në 2011, tregu grek i sigurimeve Hellenic Association of Insurance Companies (EAEE) regjistroi një rënie në primet e shkruara bruto prej 7.1%, ose 4.7 bilion Euro, krahasuar me 2010.

Në klasat e sigurimit, të gjithë produktet kryesore të sigurimit të Jetës kanë treguar një tendencë në rënie, me përjashtim të sektorëve të sigurimeve

të Jetës të lidhura me investimet dhe shëndetin. Sigurimet e Jetës edhe pse janë të lidhura me investime arritën vlerën 367 mln Euro, me një pjesë të shumës totale prej 17.4%, ndërsa menaxhimi i fondeve të pensioneve të grupit mbledhi 282 mln Euro ose 13.3% të prodhimit. Në përgjithësi, duket se volumi i drejtpërdrejtë i sigurimit të Jetës të u ul me 7.9% , sigurimet e Jetës që lidhen me investimet u rritën

Primi i shkruar Bruto (Jeta + Jo-Jeta)

	2010	2011	Ndryshimi
	(EUR mld)	(EUR mld)	(në %)
3M I 2011	1.4	1.26	-9.9%
6M I 2011	2.68	2.43	-9.20%
3M III 2011	3.88	3.56	-8.10%
Viti 2011	5.14	4.77	-7.10%

Produktet kryesore të sigurimit të Jetës

	2010	2011	Ndryshimi
	(EUR mld)	(EUR mld)	(në %)
Linja e Biznesit			
Sigurimi I Jetës	1.64	1.3	-20.7
Fonde investimi	0.28	0.37	+30.4

me 30.3% dhe ato të shëndetit shënuan një rritje prej 34.2%. Pavarësisht nga kjo sektori i sigurimit të Jetës vërejt një ulje e madhe prej 20.7%.

Lidhur me primin e sigurimit të Jo-Jetës, prodhimi ishte 2.65 bilion Euro, duke vërejtur një ulje 6.5%. Sigurimet motorike ranë me 6.2%, ndërsa sigurimi i pronës u ul me 8%. Sektori i sigurimit të detyrueshëm tani është dega më e madhe e sigurimeve të Jo-Jetës, me një prodhim të primit rreth 1.4 bilion Euro, duke mbajtur 51.5% të totalit. E dyta në prodhimin e premiumit është zjarri dhe rreziqet shtesë me 435 milion Euro ose 15.6% të sigurimit të përgjithshëm të degëve të Jo-Jetës.

Sigurimi Kasko dhe Dëmet e tjera në pronë patën një volum prej 339 milionë Euro, duke zënë 12.8% dhe e dyta një volum prej 120 milion Euro ose me 4.5% të volumit të përgjithshëm. Duke parë të dhënat në volumin e primit të sigurimit të detyrueshëm dhe kasko, vërehet se kjo përbën një vlerë prej 1.7 miliard Euro, ose 64.3% të volumit të sigurimit të Jo-Jetës.

Sigurimi nga zjarri dhe sigurimet e tjera të pronës mbledhën gati 568 milion Euro, e cila korrespondon me 21.4% të volumit të përgjithshëm ose 8.0% më pak në krahasim me vitin 2010.

Sipas një studimi të Shoqatës së Siguruesve Grekë, në 2011, tregu grek i sigurimeve Hellenic Association of Insurance Companies (EAEE) regjistroi një rënie në primet e shkruara bruto prej 7.1%, ose 4.7 bilion Euro, krahasuar me 2010.

Produktet kryesorë të sigurimit të Jo-Jetës

Linja e Biznesit	2010 (EUR mld)	2011 (EUR mld)	Ndryshimi (në %)
Kasko	0.4	0.34	-15.2
Mallrat në transport	0.03	0.03	-16.8
Zjarri dhe rreziqet shtesë	0.45	0.41	-8.7
Dëme në pronë	0.14	0.12	-14.1
Sigurimi i Detyrueshëm	1.42	1.37	-3.6
Sigurimi i Detyrueshëm për mallra	0.09	0.08	-9.9

Çeki: Rënie në tregun e sigurimeve

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto të sigurimit në Republikën Çeke u ulën pak në 2011, në monedhën çeke CZK 155.08 bilion (6.01 bilion Euro), sipas treguesve financiarë të publikuara nga Banka Kombëtare Çeke (CNB). Këto rezultate konfirmojnë trendin e tregut që rezulton edhe nga të dhënat e mbledhura nga shoqata siguruesve të Çekisë (CAP).

Përkundër krizës, sigurimi i Jetës mbajti, në monedhën vendase, tendencën e saj rritëse. CNB raportoi për primet e shkruara një vlerë mbi CZK 72.01 miliardë, ose 0.3 për qind më shumë se vitin e kaluar. Në rastet e policave të lidhura me investimet, ata kanë regjistruar një nga rezultatet

kryesore më pozitive të tërë tregut të sigurimeve: Primet e shkruara bruto arritën në CZK 36.58 bilion, ose 7.7% më shumë se në vitin 2010.

Në segmentin e sigurimit të Jo-Jetës, siguruesit çekë raportuan rezultate negative, sepse primet e shkruara bruto për të gjithë vitin e kaluar u ulën me 1.4%, në CZK 83.07 bilion. Për shembull, sigurimi i detyrueshëm, kasko dhe sigurimi nga aksidentet ishin me 8%, 5% dhe 1%. Në kundërshtim me këtë një nga rritjet më të rëndësishme është raportuar në segmentin e pronës me 2, 25% ose në CZK 25.59 bilion.

Përkundër krizës, sigurimi i Jetës mbajti, në monedhën vendase, tendencën e saj rritëse. CNB raportoi për primet e shkruara një vlerë mbi CZK 72.01 miliardë, ose 0.3 për qind më shumë se vitin e kaluar.

Për këtë numër punuan:

*R. Guri, D. Kalaja, E. Valera, E. Sherri, A. Çeku, E. Kote,
Dh. Hazbiu, R. Eltari, E. Beqir-Aga, E. Kokona*